



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 14, dt. 30.10.2023

#### **PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE (KARRIGE) TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.10296 DT.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”i ndryshuar, udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,i ndryshuar, me kërkesën nr.406 dt.09.10.2023 të Repartit ushtarak nr.4030, të Komandës Mbështetëse të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

### VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e karrigeve nga Këshilli i Qarkut Korçë, te Reparti Ushtarak nr.4030 i Komandës Mbështetëse të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
2. Gjithsej do të transferohen 12 karrige me cmimin 4900 lekë/copë  
12x4900=58800 lekë
3. Të bëhen dalje nga aktivet e Këshillit të Qarkut Korçë asetet e mësipërme, dhe të kalojnë në pronësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura me dokumentacionin përkatës
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës, burimeve njerëzore, shërbimeve emergjencave dhe zhvillimit të teritorit
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc: O. Beqiraj  
Juristi: Gj. Kristo  
Sekretari: B. Muco

Erjon NEXHIPI  
Kryetari i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### *PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE (KARRIGE) TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË*

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.10296 DT.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”i ndryshuar, udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,i ndryshuar, si dhe kërkesës nr.406 dt.09.10.2023 të Repartit ushtarak nr.4030, të Komandës Mbështetëse të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura propozojmë për miratim transferimin e 12 karrigeve nga Këshilli i Qarkut Korçë, të Reparti Ushtarak nr.4030 i Komandës Mbështetëse të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në kërkesën e sjellë pranë Këshillit të Qarkut nga ana e Repartit Ushtarak nr.4030 i Komandës Mbështetëse të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, është paraqitur nevoja që ka ky institucion për karrige zyre. Duke parë edhe mundësitë tona, pa cënuar punën e institucionit tonë, gjykuam në dhurimin dhe transferimin e 12 karrigeve nga Këshilli i Qarkut në institucionin e sipërpërmendur.

Bazuar në sa më sipër cituar, i propozojmë Këshillit të Qarkut të miratojë P/Vendimin për transferimin e aseteve (karrige)të Këshillit të Qarkut Korçë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 15, dt. 30.10.2023

#### **PËR TRANSFERIMIN E VESHJEVE POPULLORE DHE AKSESORËVE TË BLERA ME RASTIN E FESTIVALIT FOLKLORIK TË GJIROKASTRËS 2023**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.10296 DT.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"i ndryshuar, udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",i ndryshuar, me kërkesën e Qendrës të Artit dhe Kulturës, protokolluar pranë Këshillit të Qarkut Korçë me nr.602dt.13.10.2023 dhe me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

### VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e veshjeve popullore dhe aksesorëve nga Këshilli i Qarkut Korçë. te Qendra e Artit dhe Kulturës e Bashkisë Korçë.
2. Të bëhen dalje nga magazina e Këshillit të Qarkut Korçë veshjet dhe aksesorët sipas sasive dhe vlerave të listës bashkëngjitur, dhe të kalojnë në pronësi të Qendrës të Artit dhe Kulturës të Bashkisë Korçë me dokumentacionin përkatës
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës, burimeve njerëzore, shërbimeve emergjencave dhe zhvillimi të teritorit
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc: O. Beqiraj  
Juristi: Gj. Kristo  
Sekretari: B. Muco

**Erjon NEXHIPI**  
Kryetari i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### ***PËR TRANSFERIMIN E VESHJEVE POPULLORE DHE AKSESORËVE TË BLERA ME RASTIN E FESTIVALIT FOLKLORIK TË GJIROKASTRËS 2023***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.10296 DT.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”i ndryshuar, udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,i ndryshuar, si dhe bazuar në kërkesën e Qendrës të Artit dhe Kulturës, protokolluar pranë Këshillit të Qarkut Korçë me nr.602 dt.13.10.2023, ju propozojmë për miratim transferimin e veshjeve popullore dhe aksesorëve nga Këshilli i Qarkut Korçë, te Qendra e Artit dhe Kulturës e Bashkisë Korçë.

Bazuar në shkresën e Ministrisë të Kulturës nr.5682/2 dt.27.10.2022, Këshilli i Qarkut Korçë mbështeti financiarisht grupin e Qarkut Korçë, gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të Festivalit Folklorik të Gjirokastrës 2023. Pjesë e kësaj mbështetjeje ishin edhe blerja e artikujve të cituar në listën bashkëngjitur këtij p/vendimi. Këto artikuj ishin një kërkesë e Qendrës së Artit dhe Kulturës Korçë, për një prezantim sa më dinjitoz të grupit përfaqësues të Qarkut të Korçës. Pas përfundimit të Festivalit Folklorik të Gjirokastrës, veshjet dhe aksesorët ju rikthyen Këshillit të Qarkut, duke mbajtur edhe dokumentacionet përkatëse.

Në kushtet ku Qendra e Artit dhe Kulturës nuk ka mundësi të pajisë të gjithë bartësit e trashëgimisë kulturore, kërkon dhurimin e këtyre veshjeve dhe aksesorëve që u realizuan nga Këshilli i Qarkut për Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës 2023. Këto veshje do të përdoren për të gjitha aktivitetet artistike për një paraqitje sa më dinjitoze të artistëve.

Ndodhur në këto kushte , i propozojmë Këshillit të Qarkut Korçë miratimin e transferimit të veshjeve popullore dhe aksesorëve(sipas listes bashkëngjitur) nga Këshilli i Qarkut Korçë, te Qendra e Artit dhe Kulturës e Bashkisë Korçë.

### Veshjet dhe aksesorët që do ti kalojnë Qendrës së Artit dhe Kulturës

Nr	Artikulli	Sasia	Cmimi në lek/njësi	Vlera në lekë
1	Jelekë burrash Devolli pa krahë, kashmir I plotë, punuar me astar nga brenda, në kurriz me shirita të mëdha dhe me të verdha në qoshet e tij	10	9900	99000
2	Kostume burrash komplet me këmishë me mëngëtë gjera, fustanella, benevrecke, dizga, qeleshe	3	33333	99999
3	Brez	20	2400	48000
4	Corape leshi të zeza me vija me ngjyra	5	1080	5400
5	Corape jeshile të qëndisura me rombe bezhë	5	1140	5700
6	Opinga të punuara artizanat	10	6000	60000
<b>TOTALI</b>				<b>318099</b>

Kryetari i Këshillit të Qarkut  
Erjon Nexhipi



P.Finance  
Oljona Beqiraj